



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izbori Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 455/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Deçanë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.11.2013, rreth orës 16:00 në Qendrën e Votimit nr. 0106 C në Iznik- Deqan, brenda objektit të vendvotimit, militant e LDK-së, qëllimisht kanë ndaluar rrymën elektrike dhe më këtë rrastë kanë manipuluar më vota. Më këtë rrastë konsiderojmë se është bërë shkelje e nenit 34.1 të LZP si dhe neni 3.6 të Rregullave Zgjedhore nr. 09/2013

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar të subjektit politik PDK, pretendohet se subjekti politik LDK, ka manipuluar me vota, ndonëse manipulimi është bërë nga subjekti politik në fjal, andaj PZAP-i konstatoi se një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 455/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*